



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26.02.2025

Nr: 199

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

MOS FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 50 ID, DATË 21.02.2025, TË REGJISTRIT TË
DENONCIMEVE, TË PARTISË DEMOKRATIKE/PD

Sot më datë 26.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

OBJEKT: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht promovimi i investimeve me karakter social dhe përdorimi i aseteve publike.

BAZA LIGJORE: Nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

K O N S T A T O J :

Partia Demokratike më datë 21.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 50 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

“Partia Demokratike ka marrë dijeni se Kryeministri Edi Rama ka publikuar lajmin se Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” do të bashkëpunojë me Sheba Medical Center, spitalin prestigjioz të Izraelit, duke e cilësuar këtë të fundit si partnerin strategjik të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Në këtë shfaqje publike Kryeministri është shoqëruar nga Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zj. Albana Koçiu, e cila ka dhënë deklaratën e saj.”

Data: 26.02.2025

Nr: 199
Ora: 12:00



“Për mosfillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 50 ID, datë 21.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Mosfillim të procedurës administrative për denoncimin nr. 50 ID, datë 21.02.2025, të Partisë Demokratike.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të behët ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI